

**AKT THEMELIMI**  
**I SHOQERISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“ACE”**

**ALBANIA CRAFTSMAN EDUCATION**

Ne Tirane, sot me dt 01/12/2020 (dymije e njezete), shtetasja:

Z.Mimoza Memia, lindur më 01 Prill 1972 në Tirane dhe banues ne Tirane, me kombësi dhe shtetësi shqiptare, mbajtës Leternjoftimit me numer personal H25401109W madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar

Me vullnet te lire e te plote, si themelues i kesaj shoqerie ne te cilin eshte ortak i vetem e duke u bazuar dhe në përputhje me Ligjin nr.9901, datë 14.04.2008, ‘Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare’, dhe legjislacionin e zbatueshëm ne Republikën e Shqipërisë vendos të hartoje kete statut i cili do te perfshije dhe Aktin e Themelimit te Shoqerise.

Në këtë statut

- “Ligji” është Ligji 9901/2008 “Për Tregëtarët dhe Shoqëritë tregëtare”, i ndryshuar;
- “Statuti” është ky Statut i Shoqërisë;

**NENI 1**

**Data themelimit, Emri dhe Themeluesit**

Sot, me date 01/12/2020 Unë Mimoza Memia, ortake e vetme e shoqërisë në përputhje me Ligjin nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare”vendosa të themelojë Shoqerine tregtare me përgjegjësi të kufizuar të emeruar “ACE” ALBANIA CRAFTSMAN EDUCATION ,ne Tirane, emertimi i te ciles do te jete i stampuar dhe ne vulen e saj.

**Neni 1**

**1. Emërtimi dhe selia e shoqërisë :**

- 1.1. Emërtimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është “ACE”ALBANIA CRAFTSMAN EDUCATION,SHPK.
- 1.2. Selia e shoqërisë ndodhet në adresën njesia 4 ,Rruga “Aleksander Moisiu,Pallati 51/1 .kati 1 /Tiranë-Shqiperi.
- 1.3. Shoqëria mund të hapë degë dhe zyra përfaqësimi Brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

## Neni 2

### 2. Objekti i shoqërisë

Objekti i shoqërisë është:

- Kurse profesionale ne fushen e artizanatit, modes, arteve te bukura, art visual, merchanding, grafik design, concept dizajni arredues interior dhe exterior programe digjitale profesionale ,programe kompjuterike industriale,
- Konsulenca Start-up te ndermarrjeve SME sipas kategorive dhe nenkategorive te licensave profesionale.
- Krijimin e biznesit social per mundesimin e pjesemarrjes se gjere te gjenerates se re ne formimin profesional te zejeve.
- Krijimin e tregjeve te prodhimit dhe te shitjes se produkteve artizanale.
- Krijimin e reparteve dhe laboreve per prodhimin e produkteve artizanale
- Studim, projektim, dizajnim landscape, turizem, promocione.
- Workshop profesional ne shkolla te ndryshme te vendit me mentore nacionale dhe internacionale.
- Trajtime profesionale te instruktoreve akademike
- Menaxhim Strategic Retreats
- Ndërtimi i ekipit për role menaxheriale aftësi të rëndësishme përfshijnë udhëheqjen, ndërtimin e ekipit, menaxhimin e projektit dhe zgjidhjen e problemeve
- Binjakezime me institucione te ngjashme brenda dhe jashte territorit te shqiperise. Avancimin e dhe permiresimin e aftesive profesionale ne partnerite te tilla.
- Shitje, tregeti me pakice dhe shumice, pjesemarrje ne tendera private dhe shtetore.
- Programe artistike ne dizanj dhe koncepte arredues, interior dhe exterior.
- Kryerje te tregtise online permes faqeve te internetit me produkte te ndryshme te cdo lloji, perfshire pajisje tendryshme elektronike, aksesore dhe pjese kembimi per to, telefona celulare; aksesore dhe pjese kembimi per to, veshje, kepuce, artikuj sportive, ne pergjithesi artikuj industriale te cdo lloji; Krijimin e dyqaneve e-commerce B2B , B2C . Marketing online dhe produkte te tjera informatike. Shitje dhe Reklamim online.
- Keshillime per bizneset mbi sherbimet bankare.
- Keshillime te sigurimit te llojeve te ndryshme.
- Keshillime per financime te ndryshme, modelim i biznesit. keshillime mbi ristrukturimin e organizimin financiar.
- Studime tregu. Konsulence per krijimin e bizneseve artizanale, marketing, strategji biznesi, Studime plan biznesi.
- Analiza per industri te ndryshme.
- Analizim i strukturave operative financiare
- Keshillime financiare per performancen e kompanise ne treg ne krahasim me degen e industrise qe operon.
- Analiza dhe vleresim te biznesit. keshillime mbi transaksionet e shtjeve dhe analiza per strategjine e shitjeve. keshillime mbi partnershipe te ndryshme dhe negocime te termave te mareveshjes.
- Keshillime mbi vleresimin e asetave te kompanive dhe te asetave njerezore.

- Asistime ne pergatitjen e raporteve vjetore.
- Ndermjetesimin dhe tregtimin e produkteve industriale, kozmetike, teknologjike,
- Shoqëria mund te kryeje çdo veprimtarie tjeter qe lejohet nga legjislacioni
- ne fuqi i Republikës se Shqiperise
- Shoqëria me qëllim të arritjes së objektivave të përcaktuara mund të bashkëpunojë direkt ose indirekt me shoqëri të tjera shqipëtare ose të huaja që kanë objekt analog ose të lidhur me të tyren.
- Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë mund te ndryshohet ose shtohet me vendimin e Asamblese se ortakëve.

### **Neni 3**

#### **3. Kohëzgjatja e shoqërisë. Viti ushtrimor**

3.1 Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj për një afat të pacaktuar.

3.2 Viti aktivitetit financiar do të fillojë nga moment i regjistrimit të shoqërisë në regjistrin tregëtar, pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit (QKR) Tiranë dhe do të përfundojë në 31 Dhjetor.

3.3 Vitet e mëtejshme financiare fillojnë më 1 Janar dhe përfundojnë më 31 Dhjetor.

### **Neni 4**

#### **4. Kapitali themeltar**

4.1 Kapitali themeltar i nënshkruar dhe i paguar i shoqërisë është 100 (njëqind) lekë dhe përbëhet tërësisht nga kapital në para. Kapitali themeltar ndahet ne 1 (një) kuota me vlerën prej 100 (njëqind) lekë.

4.2 Në bazë të kontributit të paguar, pjesëmarrja e ortakëve në kapitalin është : Znj. Mimoza Memia zotëron 100 % të kuotave të kapitalit themeltar ose 1 kuotë.

### **Neni 5**

#### **5. Mënyra e fitimit dhe kalimit të kuotave**

5.1 Kuotat mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet :

- a) Kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) Çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj;
- c) Shitblerjes;
- d) Trashëgimisë;
- e) Dhurimit;

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

5.2 Kuotat e shoqërisë mund t'u kalohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri, kur vendos Ortaku I vetëm ose kur Asambleja vendos me shumicën e ortakëve që përfaqësojnë të paktën tre të katërtat e pjesëve të kapitalit themeltar.

5.3 Çdo ortak që dëshiron t'u kalojë të tretëve kuotën e tij ose pjesë të saj duhet më 4are t'ja ofrojë atë nëpërmjet një letër rekomandoje ortakëve të tjerë, të cilëve u takon e drejta e parablerjes ndaj së tërës, në përputhje me përqindjen e kuotave të tyre në kapitalin themeltar.

Oferta e blerjes duhet të përmbajë sasinë e kuotave që do të transferohen, çmimin përkatës dhe mënyrën e pageës.

5.4 kur jo të gjitha kuotat e ofruara blihen nga ortakët Brenda tre muajve nga dita e ofertës, shitësi ka të drejtë t'i shesë të tretëve kuotat e pashitura, me kusht që numri i shitjes të mos jetë më i ulët se ai i kërkuar ortakëve.

## **Neni 6**

### **6. Shpërndarja e fitimeve**

6.1 Fitimi i deklaruar në pasqyrat financiare të shoqërisë do të shpërndahet midis ortakut/ortakëve, në raport me kuotat e zotëruara.

Fitimi mund t'u shpërndahet ortakut/ortakëve vetëm nëse pas pgimit të dividendit :

- a) Aktivitet e shoqërië mbulojnë tërësisht deëtyrimet e saj;
- b) Shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim.

## Neni 7

### 7. Asambleja e Përgjithshme. Të drejta dhe detyrimet.

7.1 Ortaku i Vetës ose Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme :

- a) Përcaktimin e politikave tregëtare të shoqërisë;
- b) Ndryshimet e statutit;
- c) Emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- d) Emërimin dhe shkarkimin e të likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- e) Përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "d" të kësaj pike;
- f) Mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratori, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- g) Miratimin e Pasqyrave Financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- h) Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- i) Pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- j) Përfaqsimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorit;
- k) Organizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- l) Miratimin e rregullave proceduriale të mbledhjeve të Asamblesë;

Ortaku i vetëm ose Asambleja e Përgjithshme merr vendime edhe për çështje të tjera sa here është e nevojshme për të mbrojtur inteëresat e shoqërisë.

## Neni 8

### 8. Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme

8.1 Asambleja e Përgjithshme mbledhet në rastet e përcaktuara nga ligji, nga dispozitat e këtij statuti dhe sa herë është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë.

8.2 Mbledhja e zakonshme e Asamblesë së Përgjithshme thirret të paktën një herë në vit.

8.3 Asambleja e Përgjithshme thirret edhe në këto raste :

- a) Nëse sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda tre muajve në vazhdim;
- b) Kur shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5% e asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara;
- c) Kur shoqëria brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5% të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara;

8.4 Asambleja e Përgjithshme thirret nga administratori apo nga çdo ortak që përfaqëson të paktën 5% të totalit të votave në Asamblenë e Përgjithshme të shoqërisë.

8.5 Asambleja e Përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë, me postë ose nëpërmjet postës elektronike, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashkruar për mbledhjen e Asamblesë.

8.6 Asambleja e Përgjithshme i zhvillon mbledhjet e saj dhe merr vendime vetëm kur realizohet kuotimi i përcaktuar në ligj.

8.7 Ortakët gëzojnë të drejtën e votës në përpjestim me kuotat që ata zotërojnë. Çdo kuotë ka të drejtën e një vote.

8.8 Të gjitha vendimet e Asamblesë së Përgjithshme duhet të regjistrohen në proces verbal, i cili plotësohet sipas kërkesave të përcaktuara në ligj. Administratori përgjigjet për ruajtjen e kopjeve të procesverbaleve të mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme. Në momentin që shoqëria do të publikojë një faqe në internet, administratori, jo më vonë se 15 ditë nga data e mbledhjes, publikon kopje të procesverbalit të mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme në këtë faqe.

8.9 Në momentin e krijimit të kushteve sipas ligjit, ortakët mund të marrin pjesë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme edhe duke shfrytëzuar mjetet elektronike.

## **Neni 9**

### **9. Marrja e vendimeve**

9.1 Ortaku i vetëm i shoqërisë vendos për të gjitha çështjet e tjera të renditura në nr. 7 të këtij statute. Ndërsa në rastin e Asamblesë së Përgjithshme vendimet për ndryshimin e statutit, zmadhimin apo zvogelimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë merren me tri të katërtat e votimeve të ortakëve. Për çështjet e tjera të renditura në nenin 7 të këtij statute, Asambleja e Përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve.

9.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe me ligj, vlefshmëria e vendimeve, që përcaktojnë detyrime shtesë mbi ortakët, apovedime që kufizojnë të drejtat e tyre, të parashikuara në ligj ose në statut kushtëzohet nga miratimi i ortakut përkatës.

## **Neni 10**

### **10. Administratori**

10.1 Shoqëria do të administrohet nga një administrator.

10.2 Administratori i Shoqërisë do të jetë ZNJ.MIMOZA MEMIA , më 01 Prill 1972 ,lindur dhe banues ne Tirane, me kombësi dhe shtetësi shqiptare,me karte indentiteti H25401109W madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar .

10.3 Afati i emërimit të Administratorit është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritje.

10.4 Administratori ka këto të drejta dhe detyrime :

- a) Krye të gjitha veprimet të administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme;
- b) Përfaqëson shoqërinë tregtare;
- c) Kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumentave kotabël të shoqërisë;
- d) Përgatit de nëskruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe së basku me propozimet për shpërdarjen e fitimeven i paraqet këto dokumenta përpara Asamblesë së Përgjithshme për miratim;
- e) Krijon një system paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- f) Kryen rregjistrimet dhe degron të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qëndrë Kombëtare të Regjistrimit;
- g) Raporton para Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare.

10.5 Paga de shpërblimet e administratorit përcaktohen me vedim të zakonshëm të Asamblesë së Përgjithshme pse ortakut të vetëm. Shpërblimet bazë të administratorit mund t'i bëe shtesa, që mud të jeë përqindje në fitim ose të ngjashme.

Kriteret e shpërblimit : Shpërblimi individual dhe efekti vjetor i shpërblimit të administratorit në strukturën e kostove të shoqërisë tregtare publikohen së bashku me pasqyrat fianciare vjetore.

## **Neni 11**

### **11. Përfaqësimi i Shoqërisë**

11.1 Përfaqësimi i shoqërisë i përket në vijë të përgjithshme e pakufizime, Administratorit.

11.2 Përfaqësimi i shoqërisë i përket gjithashtu, përfaqësuesve të posaçëm, që mund të emërohen nga Asambleja e Përgjithshme për akte apo kategori aktesh të vecanta secili Brenda të drejtave të tij.

## **Neni 12**

### **12. Prishja e shoqërisë**

12.1 Shoqëria priset :

- a) Kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) Me vendim të ortakut të vetëm ose Asamblesë së Përgjithshme;
- c) Me hapjen e procedurave të falimentimit;
- d) Nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit Nr.9723 datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
- e) Me vendim të gjykatës;

12.2 Për prishjen e shoqërisë sipas pikës b) të nenit 12.1, Asambleja e Përgjithshme “vendos me tri të katërtat e votave të ortakëve”

## **Neni 13**

### **13. Largimi dhe/ose përjashtimi i ortakut**



13.1 Ortaku mund të largohet nga shoqëria nëse ortakët e tjerë ose shoqëria kanë kryer veprime në dëm të tij, nëse është penguar të ushtrojë drejtat e tij, nëse shoqëria I ka ngarkuar detyrime të paarsyeshme apo për shkaqe të tjera, që e bëjnë të pamundur vazhdimin e ortakërisë. Ortaku që kërkon largimin, duhet të njoftojë shoqërinë me shkrim, si edhe të parashtojë shkaqet e largimit.

13.2 Në bazë të një vendimi të zakonshëm, Asambleja e Përgjithshme mund t'i kërkojë gjykatës përjashtimin e ortakut, nëse ai ka shlyer kontributin e tij, sipas parashikimeve të statutit ose nëse ekzistojnë shkaqe të tjera të arsyeshme, sipas përcaktimeve të bëra me ligj.

13.3 Të gjitha të drejtat, që rrjedhin nga cilësia e ortakut në shoqëri, shuhen në datën e largimit ose të vendimit të reformës së prerë të gjykatës për largimin ose përjashtimin.

## **Neni 14**

### **14. Likujdimi në gjendjen e aftësisë paguese**

14.1 Me përjashtim të rasteve kur është isur një procedurë falimentimi, prishja e shoqërisë ka si pasojë hapjen e procedurave të likujdimit në gjendjen e aftësisë paguese.

14.2 Likujdimi i shoqërisë bëet sipas përcaktimeve në ligjin "Për tregëtarët dhe shoqëritë tregtare".

## **Neni 15**

### **15. Trajtimi i kokurencës. Përfaqësimi në Asamble**

15.1 Ortakët dhe administratori i shoqërisë nuk mund të mbajnë një pozicion drejtues apo të jenë të punësuar në shoqëri të tjera, që ushtrojnë veprimtari në të njëjtin sektor ekonomik me shoqërinë e parë, pa miratimin e Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

15.2 Ortaku mund të përfaqësohet në Asamblye e Përgjithshme, ë bazë të një autorizimi ga një ortak tjetër apo nga një person I tretë. Administratoret e shoqërisë uk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në Asamblye e Përgjithshme. Autorizimi mund të jepet vetëm për jëmbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, e cila përfsin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

## **Neni 16**

### **16. Njoftimet**

Njoftimet për ortakët do të bëhen me postë, në adresën e fundit të komuikuar me çdo ortak. Në momentin e krijimit të kushteve, njoftimet bëhen edhe me postë elektroike.

## **Neni 17**

### **17. Dispozita të fundit**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe me ligjin shqiptar.

## **Neni 18**

### **18. Kopje**

Ky statut hartohet në 4 kopje, sipas këtij destinacioni, një kopje noteri, një kopje për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe dy kopje për zyrën qendrore të shoqërisë.

**ORTAKU I SHOQËRISË**

**MIMOZA MEMIA**

